



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 37 datë 31.10.2019

PËR  
“MIRATIMIN E RINOVIMIT TË AUTORIZIMIT INDIVIDUAL PËR  
PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZAVE 900 MHz DHE 1800 MHz TË  
SIPËRMARRËSIT ALBTELECOM SH.A.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Ilir	Zela	Kryetar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 31.10.2019, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr. 7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Miratimin e rinovimit të Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albtelecom sh.a.*

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 72 dhe 73 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918/2008*);
2. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 44/2015*);
3. VKM nr. 496, datë 22/07/2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrencë” (*VKM nr.496*);
4. VKM nr. 277 datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (*VKM nr.277*);

5. VKD nr. 532 datë 26.12.2008, i ndryshuar me VKD nr. 937 datë 17.08.2009 dhe i ndryshuar me VKD nr. 2564 datë 11.05.2015 "Për dhënien e autorizimit individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz".
6. VKD nr. 29 datë 16.08.2019 "Për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 532 datë 26.12.2008, i ndryshuar me VKD nr. 937 datë 17.08.2009 dhe i ndryshuar VKD nr. 2564 datë 11.05.2015 "Për dhënien e autorizimit individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz".
7. Akti i dakortësisë, paraqitur në AKEP nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 235/29 prot. i AKEP datë 03.10.2019.
8. Rregullore e Brendshme "Për Funksonimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare", miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP (**Rregullore nr.7**).

### K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues i Projekt VKD;
2. Projekt Vendimi i arsyetuar;

si dhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

### V Ë R E N :

1. Sipërmarrësi "Albtelecom sh.a.", është paisur me Licencën nr. Nr.253/03/04, datë 01/03/2004, për ofrimin e shërbimit publik të lëvizshëm, tokësor, Standarti GSM në territorin e RSH. Licensa është dhënë nga Kuvendi i RSH, nëpërmjet Ligjit nr.9127, datë 29.07.2003, "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Albtelecom".
2. Me miratimin e **Ligjit Nr. 9918/2008**, AKEP ndërmoi masat përkatëse administrative për të kryer transpozimin e Licencave sipas regjimit të ri duke pajisur sipërmarrësin me Autorizimin Individual (**AI**), miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 532 datë 26.12.2008, i ndryshuar me VKD nr.937 datë 17.08.2009 dhe i ndryshuar VKD nr. 2564 datë 11.05.2015 "Për dhënien e autorizimit individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz".
3. Në përfundim të afatit të vlefshmërisë së përdorimit të frekuencave dhënë në përdorim këtij sipërmarrësi, bazuar në aktet e sipërcituara dhe në vijim të procedurave të parashikuara nga neni 73 i **Ligjit Nr.9918/2008**, si dhe të **VKM-së nr. 496**, AKEP pas VKD Nr. 9 datë 28.03.2019 "Mbi kërkesën e sipërmarrësit Albtelecom sh.a lidhur me Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz", nëpërmjet shkresës nr. 235/4 prot. i AKEP datë 29.03.2019 i ka kërkuar sipërmarrësit "Albtelecom sh.a", gatishmërinë/shprehjen e interesit të për rinovimin e Autorizimit Individual në brezin 900 MHz (2x8 MHz) dhe 1800 MHz (2x9 MHz),

interes të cilin operatori në fjalë e ka shprehur nëpërmjet shkresës nr. 235/6 prot. i AKEP datë 05.04.2019.

4. Pas marrjes së shprehjes së interesit, AKEP menjëherë ka filluar procedurën administrative për vlerësimin e përmbushjes së të gjitha kushteve të përdorimit të këtyre frekuencave në përputhje me përcaktimet e Kreut II të **VKM-së nr.496**, duke miratuar në përfundim VKD me nr.13 datë 26/04/2019, “Për miratimin e raportit përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e kushteve të përdorimit të frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 të sipërmarrësit Albtelecom sh.a”, të shoqëruar gjithashtu me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual. Raporti përmbledhës, së bashku me propozimin për çmimin referencë minimal është përcjellë pranë Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim ndjekjen e mëtejshme të procedurave të negocimit.
5. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhërin nr. 211 datë 22.05.2019 ka ngritur Komisionin *ad-hoc* për rinovimin e Autorizimit Individual të Albtelecom sh.a.
6. Komisioni *ad hoc* i negocimit ka zhvilluar disa negociata me “*Albtelecom sh.a*”, duke filluar nga data 28.05.2019 deri në datën 27.09.2019.
7. Me Vendimin nr. 29 datë 16.08.2019 Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 532 datë 26.12.2008, i ndryshuar me VKD nr.937 datë 17.08.2009 dhe i ndryshuar VKD nr. 2564 datë 11.05.2015 "Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz”, deri në nënshkrimin e Aktit të dakortësisë dhe marrjen e njoftimit zyrtar nga MIE mbi përfundimin e procedurës së negocimit me sipërmarrësin Albtelecom, në përputhje me parashikimet e VKM nr 496, datë 22.7.2014.
8. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet shkresës nr. 235/29 prot. i AKEP datë 03.10.2019 ka paraqitur në AKEP Aktin e Dakortësisë të nënshkruar nga Komisioni *ad hoc* i negocimit dhe Albtelecom sh.a, ku është rënë dakord si më poshtë:
  1. Çmimi për rinovimin e Autorizimit Individual të përdorimit të frekuencave në brezin 900 MHz dhe 1800 MHz të dhëna në përdorim sipërmarrësit Albtelecom sh.a me Licensën e vitit 2004, të ndryshuar, është: **10.900.000 Euro (dhjetë milion e nëntë qind mijë Euro)**;
  2. Mënyra e Pagesës së Rinovimit të Autorizimit Individual të përdorimit të frekuencave në brezin 900 MHz dhe 1800 MHz të dhëna në përdorim sipërmarrësit Albtelecom sh.a. të bëhet në dy këste si më poshtë:
    - 50% e shumës brenda datës **31.10.2019**;
    - 50% e shumës, brenda datës **31.03.2020** + interesin e llogaritur me yield mesatar të ponderuar të bonove të thesarit me afat maturimi 6 mujor, të emetuar në datën më të afërt që i paraprin kryerjes së pagesës së këstit të parë;
9. Me shkresën nr. 235/30 prot. datë 09.10.2019, AKEP i ka kërkuar Albtelecom sh.a shlyerjen e pagesave sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Aktin e Dakortësisë, si dhe e ka pajisur me të gjitha të dhënat e nevojshme të llogarisë së Qeverisë Shqiptare.

10. Me shkresën nr. 235/31 prot. datë 31.10.2019, Albtelecom sh.a ka njoftuar AKEP shlyerjen e kështit të parë të pagesës në llogarinë e Qeverisë Shqiptare.

## **PËR KËTO ARSYE:**

### **Duke marrë në konsideratë:**

1. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 532 datë 26.12.2008 me të cilin ish sipërmarrësit Eagle Mobile (sot Albtelecom sh.a) është pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave GSM, me afat deri 01.03.2019. Me anën e këtij Vendimi në Tabelën nr. 1 të Aneksit nr. 1 të Autorizimit Individual, këtij sipërmarrësi i janë caktuar kanalet e frekuencave GSM 900 (brezi 900 MHz), në total 8 MHz.
2. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 937 datë 17.08.2009 (për një ndryshim në VKD nr. 532 datë 26.12.2008) me të cilin ish sipërmarrësit Eagle Mobile (sot Albtelecom sh.a), në Tabelën nr. 2 të Aneksit nr. 1, i janë caktuar kanalet e frekuencave GSM 1800 (brezi 1800 MHz), në total 9 MHz.
3. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2270 datë 13.02.2013 i cili ka miratuar kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Autorizimet Individuale para bashkimit me përthithje të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a tek subjekti tregtar përthithës Albtelecom sh.a.
4. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2552 datë 10.04.2015 me të cilin sipërmarrësi Albtelecom është pajisur me Autorizim Individual për dy të drejta të reja përdorimi (2x6 MHz i çiftuar, në total 12 MHz i çiftuar), në brezin e frekuencave 1800 MHz me afat deri 01.04.2030.
5. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2564 datë 11.05.2015 i cili ka miratuar Autorizimin Individual të ri për sipërmarrësin Albtelecom sh.a për përdorimin e frekuencave të brezin 900 MHz (në total 8 MHz i çiftuar, me afat vlefshmërie deri 01.03.2019) dhe në brezin 1800 MHz (9 MHz të miratuara me VKD nr. 532/2008 dhe VKD 937/2009 me afat vlefshmërie deri 01.03.2019 si dhe 12 MHz të miratuara me VKD nr. 2552/2015 me afat vlefshmërie deri 01.04.2030) si dhe ka miratuar heqjen e kufizimeve teknologjike për këta breza.
6. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 29 datë 16.08.2019 “Për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 532 datë 26.12.2008, i ndryshuar me VKD nr. 937 datë 17.08.2009 dhe i ndryshuar VKD nr. 2564 datë 11.05.2015 “Për dhënien e autorizimit individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz”, deri në nënshkrimin e Aktit të dakortësisë dhe marrjen e njoftimit zyrtar nga MIE.
7. Aktin e Dakortësisë të nënshkruar nga Komisioni i Negocimit *ad hoc* dhe Albtelecom sh.a, për çmimin dhe mënyrën e pagesave të rinovimit të Autorizimit Individual për frekuencat e brezave 900 dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, paraqitur në AKEP nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 235/29 prot. i AKEP datë 03.10.2019.

Në mbështetje të nenit 114 të Ligjit nr.9918/2008, VKM nr. 496 si dhe Rregullores nr.7 “Për funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike” e ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP.

## V E N D O S I:

1. Të miratojë rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Altelecom sh.a, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve për njoftimin e këtij vendimi dhe dërgimin e Autorizimit Individual sipërmarrësit Altelecom sh.a.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Ilir ZELA**

**Ketrin TOPÇIU**

**Edlira DVORANI**